



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 62

25 prill

2013

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr. 278, datë 3.4.2013	Për miratimin e minimumit të specifikimeve teknike të pajisjeve të Lotarisë Kombëtare..... 2731
Vendim i KM nr. 282, datë 3.4.2013	Për pagesën e këstit të gjashtë (të fundit) të shërbimeve juridike për përfaqësimin dhe mbrojtjen në çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar nr. ARB/11/18 “Burimi S.R.L. & Eagle Games sh.a. kundër Republikës së Shqipërisë”..... 2736
Vendim i KM nr. 283, datë 27.3.2013	Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 6.11.2012, për çështjen nr. 50933/07 “Cale kundër Shqipërisë”..... 2736
Urdhër i MD nr. 2048, datë 11.4.2013	Për disa ndryshime në urdhrin nr. 248, datë 7.6.2012 “Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e mënyrave, procedurave dhe kushteve për përdorimin e sistemit elektronik “One Stop Shop-Sistemi i Noterisë””..... 2737
Vendim i ERE nr. 32, datë 10.4.2013	Mbi zhvillimin e pjesës së mbetur të ankandit vjetor të kapaciteteve të interkonjeksionit për vitin 2013..... 2738
Vendim i ERE nr. 33, datë 10.4.2013	Për miratimin e disa ndryshimeve në Rregullat e Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike..... 2738
Vendim i ERE nr. 34, datë 10.4.2013	Për licencimin e shoqërisë “A-91” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike..... 2739
Vendim i ERE nr. 35, datë 10.4.2013	Për fillimin e procedurave mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Teodori 2003” sh.p.k., për lënien peng të aseteve të saj si kolateral pranë Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim..... 2740
Vendim i ERE nr. 36, datë 10.4.2013	Për licencimin e shoqërisë “Wonder” sh.a. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike..... 2740
Vendim i ERE nr. 37, datë 10.4.2013	Për licencimin e shoqërisë “Wonder” sh.a. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike..... 2741

Vendim i ERE nr. 38, datë 10.4.2013	Për licencimin e shoqërisë “A&A Group” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.....	2742
Vendim i KKRT nr. 96, datë 3.4.2013	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat kombëtar “Radio Top Albania”.....	2743
Vendim i KKRT nr. 97, datë 3.4.2013	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Rash”.....	2743
Vendim i KKRT nr. 98, datë 3.4.2013	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Kontakt”.....	2744
Vendim i KKRT nr. 99, datë 3.4.2013	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Maria”.....	2744
Vendim i KKRT nr. 100, datë 3.4.2013	Për dhënie licence për radion private vendore “Radio Living”.....	2745
Vendim i KKRT nr. 101, datë 3.4.2013	Për dhënie licence për radion private vendore “Radio Spektrum”...	2746
Vendim i KKRT nr. 102, datë 3.4.2013	Për dhënie licence për televizionin privat kabllor “Tv Info Kabëll”.	2746
Vendim i KKRT nr. 103, datë 3.4.2013	Për zgjerim zone licencimi për radion vendore private “Radio Durrësi”.....	2747
Vendim i KKRT nr. 104, datë 3.4.2010	Për mosdhënie licence për radion vendore private “Radio Free Media”.....	2748
Vendim i KKRT nr. 105, datë 3.4.2013	Mbi mosrinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Aldo 03”.....	2748
Vendim i KKRT nr. 106, datë 3.4.2013	Mbi vlefshmërinë e licencës së subjektit televiziv vendor “TV Tele 4”.....	2750
Vendim i KKRT nr. 107, datë 3.4.2013	Mbi vlefshmërinë e licencës së subjektit televiziv vendor “Tv Rex”.....	2751
Vendim i KKRT nr. 108, datë 3.4.2013	Mbi vlefshmërinë e licencës së subjektit televiziv vendor “D1”.....	2752
Vendim i KKRT nr. 109, datë 3.4.2013	Mbi vlefshmërinë e licencës së subjektit televiziv kabllor “TV Flavio Cable”.....	2754
Vendim i KKRT nr. 110, datë 3.4.2013	Mbi vlefshmërinë e licencës së subjektit televiziv kabllor “TV me kabëll Kamza”.....	2755
Vendim i KKRT nr. 111, datë 3.4.2013	Mbi vlefshmërinë e licencës së subjektit televiziv vendor “TV ABC”.....	2756
Vendim i KKRT nr. 112, datë 3.4.2013	Mbi vlefshmërinë e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Magic Star”.....	2758
Vendim i KKRT nr. 113, datë 3.4.2013	Mbi vlefshmërinë e licencës së disa subjekteve televizive private kabllore.....	2759
Vendim i KKRT nr. 114, datë 3.4.2013	Mbi mosrinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor “Tv Kristal”.....	2760
Vendim i KKRT nr. 115, datë 3.4.2013	Mbi vlefshmërinë e licencës së subjektit televiziv vendor “Tv ARV”.....	2761
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Haxhi Tata.....	2762

VENDIM
Nr. 278, datë 3.4.2013

**PËR MIRATIMIN E MINIMUMIT TË SPECIFIKIMEVE TEKNIKE TË PAJISJEVE TË
LOTARISË KOMBËTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 31 të ligjit nr. 10 033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. PARIME TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka për qëllim vendosjen e minimumit të specifikimeve teknike për pajisjet e Lotarisë Kombëtare dhe përcaktimin e kriterëve që shërbejnë për organizimin, të cilat duhet të sigurojnë se:

- a) sistemi të veprojnë në përputhje me rregullat tregtare të Republikës së Shqipërisë;
- b) sistemi përmbush qëllimet e përgjithshme të përcaktuara në ligj.

2. Pajisjet e Lotarisë Kombëtare, për të qenë të ligjshme për përdorim, duhet të përmbushin specifikimet minimale teknike, sipas këtij vendimi. Asnjë pajisje nuk do të përdoret nga i licencuari për veprimtarinë e Lotarisë Kombëtare, nëse ajo nuk është certifikuar dhe/ose miratuar si pajisje nga Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit.

3. Sistemi i ngritur për realizimin e Lotarisë Kombëtare duhet të jetë një sistem kompjuterik me kapacitet të mjaftueshëm për përpunimin e të dhënave, ruajtjen e tyre, për ndërfaqen e komunikimit, si dhe për arkivimin e të dhënave me qëllim që të mund t’i ekzekutojë me efikasitet të gjitha detyrat për implementimin dhe zhvillimin e procesit të lotarisë. Gjithashtu, duhet të bëhet e mundur vendosja e një lidhjeje të sigurt komunikimi midis sistemit qendror dhe pajisjeve fundore.

4. Sistemi duhet të bëjë të mundur:

- a) komunikimin e çdo pajisjeje fundore drejtpërsëdrejti me serverin qendror;
- b) regjistrimin e çdo të dhëne të dërguar nga terminallet, leximin nëpërmjet terminalit të të dhënave identifikuese të biletave dhe përcaktimin nëse një biletë është fituese apo jo, pas hedhjes së shorteut;
- c) përpunimin dhe raportimin e të dhënave;
- ç) që pajisjet e Lotarisë Kombëtare të veprojnë në mënyrë lehtësisht të kontrollueshme, të besueshme dhe të sigurt;
- d) kryerjen e vetëkontrolleve të këtij sistemi;
- dh) kryerjen e kontrollit të sigurisë;
- e) kryerjen e kontrollit financiar.

II. PAJISJA QENDRORE (SERVERI)

1. Në kuptim të këtij vendimi, sistem qendror (server) quhet tërësia e serverëve, pajisjeve fundore (terminaleve), sistemi kompjuterik dhe rrjeti (network-u).

2. I licencuari duhet të instalojë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë një pajisje qendrore (server), të bazuar në një sistem të kompjuterizuar, i cili duhet të ketë kapacitetin e mjaftueshëm (në procesim të dhënash) që të kryejë me efektshmëri të gjitha veprimet e lidhura me organizimin e lotarisë, si dhe detyrimet ligjore.

3. I licencuari duhet të dokumentojë të gjithë komponentët e serverëve qendrorë, sipas skedave teknike të prodhuesit, të identifikojë komponentët thelbësorë të këtij sistemi dhe t’i paraqesë paraprakisht për miratim Njësies së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit në tërësi serverat qendrorë dhe komponentët e tyre. Quhen komponentë thelbësorë komponentët (por pa u limituar vetëm në to), si më poshtë vijon:

- a) memoria përpunuese e sistemit;



- b) fuqia proceduese e sistemit;
- c) kapaciteti i magazinimit të të dhënave.

4. I licencuari duhet të depozitojë kërkesën për miratim pranë Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit për çdo pajisje në serverat qendrorë, si për çdo komponent, ashtu edhe në total në rastin kur serverat e përdorur janë të assembluar nga prodhuesi. Gjithashtu, duhet të depozitojë për miratim pranë Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit dokumentacionin e prodhuesit së bashku me deklaratën doganore të importit (në rast se pajisja është e importuar).

5. Pajisjet fundore ose терминаlet, të cilat janë pajisje të përdorura nga i licencuari, me qëllim leximin dhe printimin e biletave, duhet të bëjnë të mundur kryerjen e veprimeve të mëposhtme:

- a) çdo terminal i lidhur të jetë i identifikueshëm në serverin qendror;
- b) të lexojnë përzgjedhjen e numrave sipas përkëmbimeve të vendosura nga lojtari;
- c) të transferojnë të dhënat në serverin qendror në kohë reale;
- ç) të printojnë biletat dhe të dhënat e lexuara sipas formatit të miratuar nga Ministria e

Financave;

d) të konfirmojnë pas skanimit të biletës së luajtur dhe të marrin përgjigje nga serveri qendror nëse kjo biletë është apo jo fituese.

III. SOFTWARE

1. Software-i i të licencuarit duhet të bëjë të mundur:

- a) identifikimin e çdo terminali të lidhur në sistem;
- b) mbledhjen e të gjitha të dhënave të ardhura nga pajisjet fundore në kohë reale;
- c) ruajtjen sipas legjislacionit në fuqi dhe të këtij vendimi të të dhënave të mbledhura;
- ç) përpunimin, sipas kërkesave ligjore, kërkesave të Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit dhe të të licencuarit, të informacionit të mbledhur;
- d) arkivimin e të dhënave të mbledhura;

dh) gjenerimin për çdo biletë të printuar nga pajisjet fundore të një numri rendor unik gjatë gjithë periudhës së licencimit.

2. Software-i duhet të parashikojë një procedurë vetëkontrolli, me anë të së cilës të kontrollohet që sistemi dhe çdo veprim i kryer nga ai është në përputhje me funksionimin e qëllimin e organizimit të lojës.

3. Çdo informacion për hyrjet në sistem duhet të regjistrohet nga i licencuari. Të gjitha të dhënat për hyrjet në sistem duhet të mblidhen në format elektronik. Ndërhyrjet e dyshimta duhet t'i raportohen Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit.

4. Në sistemin qendror nuk lejohet të instalohen *software* që nuk shërbejnë për organizimin e Lotarisë Kombëtare dhe nuk kanë lidhje me këtë aktivitet.

5. Software-i i të licencuarit duhet të jetë i aftë të gjenerojë raporte. Këto raporte duhet të jenë në format elektronik dhe të jenë të eksportueshme minimalisht në *excel* dhe *pdf*. Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit duhet t'i bëhet e mundur në çdo moment të gjenerojë raporte nga sistemi i të licencuarit, qoftë nga distanca (*on line*) qoftë në vend (*on site*). Raportet ndahen në dy kategori:

- a) raporte për ngjarje (evente) të sistemit;
- b) raporte për performancën dhe detyrimet ligjore të të licencuarit për zhvillimin e Lotarisë Kombëtare.

6. Në raportet për ngjarje të sistemit përfshihen të paktën rastet kur:

a) sistemi nuk vepron sipas rregullave të vendosura në këtë vendim apo sipas rregullores së të licencuarit dhe indikacioneve të Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit;

b) sistemi, për arsye të ndryshme, pjesërisht apo plotësisht, nuk është në funksionim (*sistem down*);

c) sistemit i është bërë *back-up* dhe ky sistem funksionon me *filet* e *back-up-it*;

- ç) kryhen punime apo testime të sistemit;
- d) çdo aplikacion vetëkontrolli sinjalizon një anomali.

7. Në raportet e performancës përfshihen të paktën:

a) numri total i shitjeve dhe vlera në lekë e biletave, progresiv, gjatë gjithë periudhës së licencimit dhe i ndarë ky sipas nëntotalit për muaj/shorte/qark/terminal/tipologji loje;

b) çmimet e fituara nga lojtarë, të ndara gjatë gjithë periudhës së licencimit sipas nëntotalit muaj/shorte/qark/terminal/tipologji loje. Gjithashtu, duhet të jetë dhe për çmimet e patërhequra nga fituesit dhe *jackpot*-i i caktuar;

c) detyrimet financiare në rend mujor/vjetor dhe gjatë gjithë periudhës së veprimtarisë, të ndara në zëra sipas detyrimeve që i licencuari ka ndaj Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, detyrime ndaj administratës tatimore. Këto raporte duhet të jenë të veçanta për çdo kategori loje që organizon i licencuari;

ç) numri i pikave të shitjes dhe adresat e tyre duke përfshirë çdo ndryshim.

8. Përveç raporteve të përcaktuara në pikat 6 dhe 7, nëse Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit e gjykon të arsyeshme, i licencuari duhet të gjenerojë edhe raporte të tjera për të dhënat e ruajtura në sistemin e Lotarisë Kombëtare.

9. I licencuari duhet të sigurojë që përgjatë ose në përfundim të periudhës së licencimit, me kërkesë të Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, të ofrojë të gjitha ekstraktet e nevojshme të ruajtura në databazën e tij për të siguruar vijueshmërinë e pagesave të çmimeve në një mënyrë të përshtatshme. Gjithashtu, i licencuari duhet të mundësojë kalimin për tek i licencuari pasardhës të të gjitha të dhënave të nevojshme në lidhje me biletat ende të vlefshme.

10. Nëse kërkohet nga Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, i licencuari duhet të sigurojë integritet të sigurt të sistemeve të jashtme me sistemin e Lotarisë Kombëtare nëpërmjet ndërfaqeve të jashtme të programuara ose nëpërmjet platformës së interoperabilitetit. Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe çdo organ tjetër i caktuar me ligj duhet të kenë akses leximi në bazën e të dhënave të të licencuarit.

IV. RRJETI

1. Kjo pjesë përmbledh specifikimet minimale teknike për komunikimin e të dhënave brenda sistemit qendror, mes sistemit qendror dhe pajisjeve fundore, si dhe të sistemit qendror e palëve të treta.

2. Çdo komunikim elektronik ndërmjet sistemit qendror dhe pajisjeve fundore apo palëve të treta duhet të kalojë në të paktën 1 sistem mbrojtjeje (*firewall* apo të ngjashëm).

3. I licencuari duhet të sigurohet që çdo informacion që kalon në rrjet të jetë i kriptuar për sa i përket veprimtarisë së Lotarisë Kombëtare.

4. Me qëllim miratimit nga Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit të rrjetit të të licencuarit duhet të paktën që ky i fundit të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) skemën e rrjetit (infrastrukturën);

b) skemën e kriptimit të informacionit;

c) procedurat dhe mjetet e rëlevimit të ndërhyrjeve të paautorizuara dhe procedurat në rast sulmi nëpërmjet rrjetit.

V. SIGURIA

1. Serverat qendrorë duhet të jenë të vendosur në një ambient të mbyllur e të siguruar, hyrja në të cilin mund të bëhet vetëm nga personel i autorizuar. I licencuari duhet të mbajë regjistër elektronik dhe shkresor për çdo person i cili hyn në këtë ambient, për arsyet e hyrjes, veprimet që kryhen brenda ambientit dhe kohëzgjatjen e qëndrimit në ambient. Një sistem alarmi duhet të jetë i ngritur me qëllim evidentimin e hyrjes së paautorizuar.

2. Të gjitha pajisjet elektrike/elektronike të sistemit qendror, si dhe pajisjet ndihmëse për funksionimin e tij (ndriçim, sistemi i kondicionimit të ajrit, linja telefonike etj.), duhet të jenë të lidhura me pajisje të tilla që të sigurojnë mbrojtjen e sistemit nga luhajtje të rrymës elektrike dhe



vazhdimësi të funksionimit të sistemit në rast të shkëputjes së energjisë elektrike. Në rast të ndërprerjeve të gjata të energjisë elektrike, pajisje të tilla, si gjenerator, duhet të vihen në funksionim për të evituar fikjen e sistemit qendror.

3. Të gjitha pajisjet e instaluara në ambientet e pajisjes qendrore duhet të jenë të tokëzuara. Të gjitha sistemet e emergjencës (si p.sh. UPS-ja, gjeneratori, ndriçimi i emergjencës etj.), duhet të testohen të paktën 1 (një) herë çdo tre muaj, duke mbajtur shënim datën, orën dhe procedurën e testimit. Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit mund të kërkojë dërgimin e një specialisti të tij për pjesëmarrjen në testim, si dhe të kërkojë nga i licencuari regjistrin e plotë të testeve.

4. Në rast se mungesa e rrymës vazhdon tej kapacitetit të pajisjeve që sigurojnë vazhdimësinë e rrymës, por jo më pak se 24 (njëzet e katër) orë, duhet të bëhet e mundur fikja e sistemit qendror në mënyrë korrekte, pa pasur humbje të të dhënave, si dhe duhet të vihet në funksionim sistemi që ndodhet në qendrën e vazhdueshmërisë së biznesit (*Business Continuity Centre*).

5. Qendra e të dhënave primare, ku do të vendoset sistemi qendror, duhet të jetë e pajisur me sistemin e duhur të kondicionimit dhe ventilimit, sistem kamerash që inkuadrojnë çdo hapësirë të ambientit (brenda dhe jashtë tij, 24/7/365), sistem monitorimi të ndryshimit të parametrave të brendshëm (si: temperatura, lagështia etj.), sistem për dedektimin e zjarrit etj. Qendra e të dhënave primare duhet të jetë sipas standardeve më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare. Filmimet e regjistruara duhet të ruhen për 30 (tridhjetë) ditë.

6. I licencuari duhet të ngrejë një procedurë informimi për çdo ngjarje në serverin qendror. Gjithashtu, duhet të parashikohen procedura për zgjidhjen sa më të shpejtë të problemit. Një regjistër me çdo avari apo problem të lindur me sistemin duhet të mbahet dhe t'i vihet në dispozicion Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit sa herë që ky i fundit e gjykon të arsyeshme.

7. I licencuari për Lotarinë Kombëtare duhet të sigurojë mbrojtjen me antivirus dhe/ose "firewall" kudo ku ekziston rreziku i infektimit me viruse (apo mjete të ngjashme), sulm kibernetik etj.

8. I licencuari i Lotarisë Kombëtare duhet të ngrejë dhe një sistem "back-up-i" në një ambient, të ndryshëm nga ai i pajisjes qendrore, për të parandaluar humbjen e të dhënave.

9. I licencuari për Lotarinë Kombëtare nuk mund t'i ndryshojë karakteristikat teknike dhe specifikimet e pajisjeve, pa miratimin paraprak të Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit.

10. Aplikacionet, baza e të dhënave dhe sistemi operativ duhet të jenë të mbrojtura me fjalëkalime (*password*).

11. Për çdo sulm apo keqpërdorim të sistemit, i licencuari duhet të ketë procedura për raportim të Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, si dhe procedura për ndjekjen e zgjidhjen e problemit. Sulmet ndaj sistemit të sigurisë janë të paktën:

- a) përpjekje e paautorizuar për të hyrë në sistem;
- b) përpjekje e paautorizuar për ndryshim të dhënash;
- c) përpjekje e paautorizuar për të ndryshuar konfigurimin e sistemit apo sigurisë së tij, rregullave të lojës, bazës së të dhënave etj.

I licencuari duhet të sigurohet se ruajtja e fjalëkalimeve është e kriptuar dhe të ketë një regjistër me të dhënat e hyrjes në sistem të çdo përdoruesi, kompetencat e tij sipas rangut dhe veprimeve të kryera nga ky i fundit në sistem.

12. Regjistrimi dhe ruajtja e logeve duhet të kryhet nga i licencuari dhe të ruhet përveçse në sistemin qendror edhe në atë të emergjencës (*back-up*). Në këto të dhëna duhet të paktën të përfshihen:

- a) të gjitha të dhënat/transaksionet e rëndësishme, të ruajtura me datën dhe orën e kryerjes;
- b) logimet dhe baza e të dhënave që duhet të jenë të dublikuara (në sistemin qendror dhe në një sistem (*back-up*));

c) të gjitha rregullimet, modifikimet dhe vendosjet e biletave të lojës për shorteun së bashku me identifikimin e modifikuesit/vendosësit dhe datën/orën e modifikimit/vendosjes.

Baza e të dhënave duhet të ruhet të paktën 3 (tre) vjet. Të dhënat që kanë apo mund të kenë efekte financiare duhet të ruhen të paktën 5 (pesë) vjet.

13. Në raste fatkeqësie (zjarri, përmytjeje etj.), i licencuari duhet të sigurojë ruajtjen e të paktën të dhënave financiare dhe që kanë lidhje me shorteun. Këto të dhëna të jenë të rikuperueshme deri në momentin e ndodhjes së fatkeqësisë. I licencuari duhet të bëjë të paktën çdo ditë një *back-up* të sistemit dhe të të dhënave të rëndësishme në sistemin e emergjencës (*back-up-it*).

14. I licencuari duhet të sigurojë që, në rast fatkeqësie dhe pasi të konstatojë që sistemi nuk mund të rikuperohet në asnjë mënyrë tjetër, të bëjë *back-up-in* nga dita e mëparshme dhe të jetë në gjendje të rikuperojë të dhënat e rëndësishme sipas përcaktimeve të vendosura nga Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit.

VI. PAJISJA QË SHËRBEN PËR HEDHJEN E SHORTEUT

1. Pajisja që shërben për hedhjen e shorteut (goglave) duhet të jetë e certifikuar nga Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit dhe me pullën e sigurisë së vendosur nga kjo e fundit. Me qëllim certifikimin e kësaj pajisjeje, duhet të dorëzohet pranë Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit dokumentacioni i mëposhtëm:

a) certifikatë nga prodhuesi;

b) certifikatë testimi të prodhuesit, e cila certifikon se pajisja i tërheq goglat në mënyrë të rastësishme;

c) njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit apo çdo organ tjetër i përcaktuar me ligj mund të testojë pajisjet e hedhjes së shortit në çdo kohë.

2. Nga Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit i vendoset pullë sigurie çdo seti me gogla, i cili do të përdoret nga i licencuari. Çdo set me gogla (nga 0 deri në 39), i mbyllur në kutinë përkatëse, i dërgohet për miratim Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit. Pasi ky i fundit vëren se pesha dhe diametri i goglave është brenda limitit të pranueshëm ($\pm 1.1\%$ për diametrin, bazuar në diametrin mesatar të të gjitha goglave të setit përkatës dhe $\pm 2.1\%$ për peshën, bazuar në peshën mesatare, të të gjitha goglave të setit përkatës) dhe nuk ka në to asnjë deformim, i cili mund të ndikojë në daljen e rastësishme të tyre, vendos pullën e sigurisë dhe mbyll kutinë. Në rast se i licencuari vendos se duhet të ndërrojë setin e goglave, këtë mund ta bëjë vetëm me një tjetër set të miratuar nga Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit.

3. Një përfaqësues i Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit duhet të jetë gjithnjë prezent në hedhjen e shorteut nga i licencuari. Ndër të tjera, përfaqësuesi kontrollon se goglat dhe pajisja e përdorur janë ato të miratuara dhe të certifikuara nga Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit. Detyrat e tjera të përfaqësuesit vendosen nga rregullorja e lojës së të licencuarit dhe nga Drejtori i Përgjithshëm i Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit.

4. Në rastin kur i licencuari e zhvillon shorteun në mënyrë elektronike, aplikimet duhet të jenë instaluar në server të veçantë, që duhet të plotësojnë të gjitha kërkesat e sigurisë. Të gjitha pajisjet dhe aplikimet duhet të miratohen nga Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit.

5. Pika 1 e këtij kreu është e vlefshme edhe në rastin kur i licencuari e zhvillon shorteun në mënyrë elektronike (jo me gogla) apo në çdo lloj mënyre tjetër.

VII. DISPOZITA TË FUNDIT

Vendimi nr. 682, datë 11.6.2009 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e minimumit të specifikimeve teknike të pajisjeve të Lotarisë Kombëtare”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr. 282, datë 3.4.2013

PËR PAGESËN E KËSTIT TË GJASHTË (TË FUNDIT) TË SHËRBIMEVE JURIDIKE PËR PËRFAQËSIMIN DHE MBROJTJEN NË ÇËSHTJEN E ARBITRAZHIT NDËRKOMBËTAR NR. ARB/11/18 “BURIMI S.R.L. & EAGLE GAMES SHA KUNDËR REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Drejtësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, t’i shtohet fondi 87 500 (tetëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind) euro, për të përballuar pagesat e tarifave avokatore të përfaqësimit (kësti i gjashtë dhe i fundit), për çështjen e arbitrazhit ndërkombëtar “Burimi s.r.l. & Eagle Games sh.a., kundër Republikës së Shqipërisë”, që zhvillohet në Qendrën Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve nga Investimet (ISCID).

2. Ky fond, i konvertuar në lekë me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën kur do të kryhet pagesa, i transferohet Ministrisë së Drejtësisë për të bërë pagesën.

3. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

4. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 283, datë 27.3.2013

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 6.11.2012, PËR ÇËSHTJEN NR. 50933/07 “CALE KUNDËR SHQIPËRISË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46 të Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, datë 6.11.2013, për çështjen nr. 50933/07 “Cale kundër Shqipërisë”, në shumën 1 650 (një mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) euro, plus edhe pagesën e tatimit mbi të ardhurat për dëmshpërblimin në lidhje me 2736

dëmin material, si dhe 1 500 (një mijë e pesëqind) euro, plus çdo taksë që mund të jetë e ngarkueshme në lidhje me dëmin moral. Vlera në total e detyrimit është 3 150 (tre mijë e njëqind e pesëdhjetë) euro.

2. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Shuma e përcaktuar si detyrim në pikën 1 të këtij vendimi, të depozitohet në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesit, Stefanaq Cale dhe të konvertohet në lekë me kursin e këmbimit të bankës, ku është depozituar shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

4. Pagimi i shumës së depozituar sipas pikës 4 të këtij vendimi, në favor të ankuesit, z.Stefanaq Cale, të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së të gjithë dokumentacionit ligjor të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga Buxheti i Shtetit, brenda datës 6 maj 2013.

Në rast mospagimi brenda këtij afati, mbi shumën e mësipërme paguhen interesa të thjeshta të barabarta me kursin marzhinal të huas së Bankës Qendrore Europiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus tre për qind.

5. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

URDHËR
Nr. 2048, datë 11.4.2013

PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 248, DATË 7.6.2012 “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR “PËRCAKTIMIN E MËNYRAVE, PROCEDURAVE DHE KUSHTEVE PËR PËRDORIMIN E SISTEMIT ELEKTRONIK “ONE STOP SHOP-SISTEMI I NOTERISË””

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7 paragrafi 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, të ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 248, datë 7.6.2012 Për miratimin e rregullores Për përcaktimin e mënyrave, procedurave dhe kushteve për përdorimin e sistemit elektronik “One Stop Shop-Sistemi i Noterisë”, bëhen këto ndryshime:

1. Neni 7 pika 1 ndryshohet si vijon:

“Pas regjistrimit si përdorues, noteri mund të ketë akses në sistemin OSS, për të marrë shërbime nga ZRPP-ja, për pasuritë e paluajtshme, por duhet të vërtetojë kryerjen e një pagese paradhënie në llogarinë e ZRPP-së “Mjete në ruajtje të noterëve-OSS”, në bankat e nivelit të dytë, në bazë të faturës për arkëtim që do të tërheqë nga ZRPP-ja.

Kjo llogari hapet nga ZRPP-ja dhe përdoret vetëm për qëllime të mbulimit të shpenzimeve për shërbimet që ai do të marrë nga ZRPP-ja.

Llogaria nuk mund të përdoret për qëllime të kompensimit të detyrimeve monetare që noteri mund të ketë ndaj ZRPP-së.”.

2. Neni 9 pika 3 ndryshohet si vijon:



“ZRPP-ja me kërkesë në degën e bankës së nivelit të dytë, do të bëjë transferimin e shumave me të cilat është pakësuar llogaria elektronike e noterit, për shkak të shërbimeve të përfituara nga llogaria “Mjete në ruajtje të noterëve-OSS”, në bankën e nivelit të dytë, në llogarinë përkatëse të të ardhurave të ZRPP-së.”

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Eduard Halimi

VENDIM
Nr. 32, datë 10.4.2013

**MBI ZHVILLIMIN E PJESËS SË MBETUR TË ANKANDIT VJETOR TË KAPACITETEVE
TË INTERKONJEKSIONIT PËR VITIN 2013**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “ç” paragrafi “ii” dhe 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës 7 germa “b” të “Modelit të tregut të energjisë elektrike” të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 10.4.2013, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

VENDOSI:

1. OST sh.a. të zhvillojë pjesën e mbetur të ankandit vjetor për kapacitetet ndërkufitare të interkonjeksionit, në drejtim importi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 33, datë 10.4.2013

**PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLAT E TREGUT SHQIPTAR TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 54 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 26 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.4.2013, pasi shqyrtoi propozimin e drejtorive teknike për një ndryshim në Rregullat e Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike,

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit 179, datë 28.12.2012 të Bordit të Komisionerëve të ERE, ndryshohet si më poshtë:

Vendimi nr. 93, datë 16.7.2012, do t'i shtrijë efektet deri në 31 maj 2013.

2. Ngarkohet Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë subjektet e interesuara për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM

Nr. 34, datë 10.4.2013

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “A-91” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGIJË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, neneve 9 dhe 13 pikat 1 germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “g”, neneve 8; 9; 13 dhe 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.4.2013, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “A-91” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “A-91” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik (nenin 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “A-91” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani



VENDIM
Nr. 35, datë 10.4.2013

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“TEODORI 2003” SH.P.K, PËR LËNIEN PENG TË ASETEVE TË SAJ SI KOLATERAL
PRANË BANKËS EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 20 pika 1 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 6, 7 dhe 8 të rregullores “Për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin nr. 89, datë 13.12.2006 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, pikave 1.3 dhe 1.6 të licencës me seri PV10P “Për prodhimin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.4.2013, pasi shqyrtoi kërkesën për lënie peng të aseteve si kolateral nga shoqëria “Teodori 2003” sh.p.k. pranë Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Teodori 2003” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit”, si më poshtë:

- Neni 7 pikat 1.1 dhe 1.2, emri dhe adresa e plotë e të licencuarit (janë paraqitur në mënyrë të plotë dhe korrekte).

- Neni 7 pikat 1.3 germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”, “h”, përshkrimi i të licencuarit dhe informacioni lidhur me aktivitetin e tij. (Ky informacion është dhënë i plotë me të gjitha detajet e kërkuara nga rregullorja.)

- Neni 7 pika 2, 3, 4 dhe 5 (ky informacion është plotësuar tërësisht).

Nuk është paraqitur lista e aseteve për t’u lënë peng si kolateral.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Teodori 2003” sh.p.k., për lënie peng si kolateral të aseteve të shoqërisë pranë “BERZH”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM
Nr. 36, datë 10.4.2013

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “WONDER” SHA NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, neneve 9 dhe 13 pikat 1 germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “g”, neneve 8; 9; 13 dhe 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në
2740

mbledhjen e tij të datës 10.4.2013, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Wonder” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Wonder” sh.a., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (nenin 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Wonder” sh.a. në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM

Nr. 37, datë 10.4.2013

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “WONDER” SHA NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGIJË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 3 pika 31, 8 pika 2 germa “a”; 9 dhe nenit 45 pika 4 dhe 48 pika 2 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa “f”, 5 pika 1 germa “f” dhe 13 dhe 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18 pikat 1 germa “a” dhe 3 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve, nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.4.2013, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Wonder” sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “Wonder” sh.a., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:



- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 germat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë “Wonder” sh.a., në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike, me një afat 5-vjeçar.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM **Nr. 38, datë 10.4.2013**

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “A&A GROUP” SHPK NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, neneve 9 dhe 13 pika 1 germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1 germa “g”, neneve 8; 9; 13 dhe 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.4.2013, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “A&A Group” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “A&A Group” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik (nenin 9, pika 4.10) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “A&A Group” sh.p.k., në aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani

VENDIM

Nr. 96, datë 3.4.2013

**PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT KOMBËTAR
“RADIO TOP ALBANIA”**

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit për rinovimin e licencës dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik privat kombëtar “Radio Top Albania”, për një afat të ri 6-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore analoge.

2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.

Ky vendim i shtrin efektet që nga data 3.1.2013 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endirë Bushati

VENDIM

Nr. 97, datë 3.4.2013

**PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR
“RADIO RASH”**

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit për rinovimin e licencës dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit



VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik privat vendor “Radio Rash”, për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore analoge.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
Ky vendim i shtrin efektet që nga data 3.1.2013 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE
Endirë Bushati**

VENDIM

Nr. 98, datë 3.4.2013

**PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR
“RADIO KONTAKT”**

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit për rinovimin e licencës dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik privat vendor “Radio Kontakt”, për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore analoge.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
Ky vendim i shtrin efektet që nga data 16.1.2013 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE
Endirë Bushati**

VENDIM

Nr. 99, datë 3.4.2013

**PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR
“RADIO MARIA”**

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit për rinovimin e licencës dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik privat vendor “Radio Maria”, për një afat të ri 3-vjeçar në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore analoge.

2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.

Ky vendim i shtrin efektet që nga data 3.1.2013 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endirë Bushati

VENDIM

Nr. 100, datë 3.4.2013

**PËR DHËNIE LICENCE PËR RADION PRIVATE VENDORE “RADIO LIVING”
SUBJEKTIT: SHOQËRIA “J&P PRO” SHPK**

Në mbështetje të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor”, miratuar me vendimin nr. 355, pika 2, datë 29.8.2005, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor”, miratuar me vendimin nr. 355, pika 1, datë 29.8.2005, rregullores “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010 të KKRT-së, si dhe frekuencave të lira të shpallura në mënyrë publike, në mbështetje të vendimit nr. 40, datë 1.2.2013 “Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë privatë vendorë radiofonikë”, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë shoqërisë “J&P PRO” sh.p.k., licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator radiofonik vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal rrethet Tiranë – Durrës, në frekuencën 107.1 MHz.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endirë Bushati



VENDIM
Nr. 101, datë 3.4.2013

PËR DHËNIE LICENCE PËR RADION PRIVATE VENDORE “RADIO SPEKTRUM”
SUBJEKTIT: SHOQËRIA “VALA 2013” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor”, miratuar me vendimin nr. 355, pika 2, datë 29.8.2005, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor”, miratuar me vendimin nr. 355, pika 1, datë 29.8.2005, rregullores “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010 të KKRT-së, si dhe frekuencave të lira të shpallura në mënyrë publike, në mbështetje të vendimit nr. 59, datë 20.2.2013 “Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë privatë vendorë radiofonikë”, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T’i japë shoqërisë “Vala 2013” sh.p.k., licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator radiofonik vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal rrethet Tiranë – Durrës, në frekuencën 96.4 MHz.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endirë Bushati

VENDIM
Nr. 102, datë 3.4.2013

PËR DHËNIE LICENCE PËR TELEVISIONIN PRIVAT KABLLOR “TV INFO KABËLL”

Në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, miratuar me vendimin nr. 221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010, si dhe vendimit të KKRT-së, nr. 85, datë 11.3.2013 “Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë radiotelevizivë kabllorë”, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit për t’u licencuar si operator privat kabllor dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. T'i japë licencë subjektit "Info Kabëll" sh.p.k., duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për "TV Info Kabëll", për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal rrethet Tiranë-Durrës.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endirë Bushati

VENDIM

Nr. 103, datë 3.4.2013

**PËR ZGJERIM ZONE LICENCIMI PËR RADION VENDORE PRIVATE "RADIO
DURRËSI" SUBJEKTIT: "RADIO DURRËSI" SHPK**

Në mbështetje të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores "Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor", miratuar me vendimin nr. 355, pika 2, datë 29.8.2005, rregullores "Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor", miratuar me vendimin nr. 355, pika 1, datë 29.8.2005, rregullores "Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010, të KKRT-së, si dhe frekuencave të lira të shpallura në mënyrë publike në mbështetje të vendimit nr. 91, datë 27.3.2013 "Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë privatë vendorë radiofonikë", pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të miratojë zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit "Radio Durrësi" sh.p.k., për radion vendore private "Radio Durrësi", sipas licencës nr. 087/FML, në qarqet Fier-Vlorë.

2. Karakteristikat teknike janë pjesë e licencës përkatëse dhe i nënshtrohen të gjitha kushteve të saj.

3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për pasqyrimin e ndryshimeve përkatëse në licencën e subjektit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endirë Bushati



VENDIM
Nr. 104, datë 3.4.2010

**PËR MOSDHËNIE LICENCE PËR RADION VENDORE PRIVATE “RADIO FREE
MEDIA” SUBJEKTIT: “FREE MEDIA” SHPK**

Në mbështetje të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor”, miratuar me vendimin nr. 355, pika 2, datë 29.8.2005, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor”, miratuar me vendimin nr. 355, pika 1, datë 29.8.2005, rregullores “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010 të KKRT-së, si dhe frekuencave të lira të shpallura në mënyrë publike në mbështetje të vendimit nr. 40, datë 1.2.2013 “Për organizimin e konkurrimit të kandidaturave për operatorë privatë vendorë radiofonikë”, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit dhe mbështetur në propozimin e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të mos licencojë për transmetim radiofonik privat analogjik tokësor subjektin “Free Media” sh.p.k., pasi në dokumentacionin e paraqitur mungonte: garancia bankare; të dhënat mbi programet; emërtimi i subjektit dhe vendndodhja; të dhënat mbi numrin e punonjësve që parashikohet të punojnë dhe kualifikimin e tyre.

2. Subjekti mund të ankohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endirë Bushati

VENDIM
Nr. 105, datë 3.4.2013

**MBI MOSRINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR
“RADIO ALDO 03”**

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endirë Bushati	kryetare
Sami Nezaq	zëvendëskryetar
Suela Musta	anëtare
Gent Ibrahim	anëtar
Zylyftar Bregu	anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Mbi mosrinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Aldo 03”.

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21, neni 33 pikat 1 dhe 5 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimit nr. 30, datë 1.2.2013 Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VËREN SE:

Shoqëria “Aldo 03” sh.p.k. është licencuar nga KKRT-ja, me vendimin nr. 171, datë 3.9.2003, si operator radiofonik privat vendor në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për radion private vendore “Radio Aldo 03”. Me vendimet nr. 658, datë 18.12.2007 dhe nr. 246, datë 3.10.2011, KKRT-ja ka rinovuar licencën për këtë subjekt; ndërsa me vendimin nr. 30, datë 1.2.2013, KKRT-ja ka filluar procedurën për pavlefshmërinë e licencës për subjektin “Radio Aldo 03”, për shkak të mosshlyerjes së detyrimeve financiare. Licenca e subjektit ka përfunduar në datën 3.9.2012.

Në përputhje me ligjin nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi licencimin dhe rilicencimin e operatorëve radio e televizive”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010 të KKRT-së dhe urdhrin nr. 45, nr. 179 prot., datë 20.3.2013, të ndryshuar të kryetarit të KKRT-së, më datë 1.4.2013, komisioni i shqyrtimit të dokumentacionit u mblodh për të shqyrtuar, ndër të tjera, edhe aplikimin për rinovimin e licencës për subjektin radiofonik privat vendor “Radio Aldo 03”.

Bazuar në pikën 2.2 paragrafi C të rregullores “Mbi licencimin dhe rilicencimin e operatorëve radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010 të KKRT-së subjektin radiofonik privat vendor “Radio Aldo 03”, komisioni i shqyrtimit të dokumentacionit nuk realizoi shqyrtimin paraprak dhe tërësor të aplikimit për këtë subjekt, pasi “Radio Aldo 03” nuk kishte shlyer detyrimet financiare për periudhën e vlefshmërisë së licencës në shumën 177.400 lekë, duke vendosur skualifikimin e tij.

Neni 33, pikat 1 dhe 5, të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikon se:

“Licenca bëhet e pavlefshme kur:

1. mbaron afati i vlefshmërisë dhe ajo nuk është rinovuar;
5. kërkuesi...nuk realizon detyrimet financiare të parashikuara me ligj pas 90 ditëve nga momenti kur merr dijëni zyrtarisht për miratimin e saj”.

Nga ana tjetër, me vendimin nr. 30, datë 1.2.2013, KKRT-ja ka filluar procedurën për pavlefshmërinë e licencës për subjektin “Radio Aldo 03”, për shkak të mosshlyerjes së detyrimeve financiare.

PËR KËTO ARSYE:

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7 pika 21, nenit 33, pikat 1 dhe 5, të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimit nr. 30, datë 1.2.2013,

VENDOSI:

1. Të mos rinovojë licencën për subjektin radiofonik privat vendor “Radio Aldo 03”.
 2. Të bëjë të pavlefshme licencën nr. 047/FML të subjektit radiofonik privat vendor “Radio Aldo 03”.
 3. Subjekti sipas pikës 1 të ndërpresë menjëherë transmetimin.
 4. Ngarkohet administrata e KKRT-së për zbatimin e këtij vendimi.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30-ditësh nga marrja dijëni, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endirë Bushati



VENDIM
Nr. 106, datë 3.4.2013

MBI VLEFSHMËRINË E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR
“TV TELE 4”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endirë Bushati	kryetare
Sami Nezaq	zëvendëskryetar
Suela Musta	anëtare
Gent Ibrahim	anëtar
Zylyftar Bregu	anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Mbi vlefshmërinë e licencës së subjektit televiziv privat vendor “TV Tele 4”.

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21, neni 33 pika 5 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VËREN SE:

Me vendimin nr. 800, datë 17.4.2009, KKRT ka licencuar shoqërinë “Antipatrea” sh.p.k., për subjektin televiziv privat vendor “TV Tele 4”, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat vendor në fushën e transmetimeve televizive analoge për të mbuluar me sinjal qarkun Berat.

KKRT-ja konstaton se subjekti televiziv “TV Tele 4” nuk ka shlyer detyrimet financiare, pagesën vjetore për licencë dhe taksën për shërbimet rtv, pavarësisht njoftimeve të herëpashershme nga KKRT.

Kështu, KKRT-ja me shkresat nr. 316 prot., datë 23.2.2010, nr. 604 prot., datë 19.5.2010, nr. 786 prot., datë 23.7.2010, nr. 578 prot., datë 4.4.2011, nr. 800 prot., datë 29.4.2011 dhe nr. 286 prot., datë 23.2.2012, ka njoftuar zyrtarisht subjektin televiziv “TV Tele 4”, por pavarësisht këtyre njoftimeve subjekti vazhdon të jetë debitor ndaj KKRT-së, në masën 306.000 lekë, ndërsa ndaj Buxhetit të Shtetit në masën 384.000 lekë. Vlera totale e detyrimit financiar është 690.000 lekë.

Më tej, me shkresat nr. 761 prot., datë 5.6.2012 dhe nr. 1065 prot., datë 13.7.2012, i është ripërsëritur kërkesa për kryerjen e pagesave duke u paralajmëruar se në rast të mosshlyerjes së detyrimeve, nga ana e KKRT-së, do të ndiqen procedurat për bërjen të pavlefshme të licencës së subjektit.

Me vendimin nr. 19, datë 18.1.2013, KKRT-ja ka njoftuar subjektin televiziv privat vendor “TV Tele 4” për fillimin e procedurave për bërjen të pavlefshme të licencës së subjektit. Pavarësisht se është njoftuar edhe për vendimin e mësipërm, subjekti vazhdon të jetë debitor ndaj KKRT-së.

Neni 33 i ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikon se:

“Licenca bëhet e pavlefshme kur:

...

5. kërkuesi nuk realizon detyrimet financiare të parashikuara me ligj pas 90 ditëve nga momenti kur merr dënimin zyrtarisht për miratimin e saj.”.

PËR KËTO ARSYE:

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7, pika 21, nenit 33, pika 5 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të bëjë të pavlefshme licencën nr. 092/TVL të subjektit televiziv privat vendor “TV Tele 4”.
 2. Subjekti sipas pikës 1 të ndërpresë menjëherë transmetimin.
 3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditësh nga marrja dijoni, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endirë Bushati

VENDIM
Nr. 107, datë 3.4.2013

MBI VLEFSHMËRINË E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR
“TV REX”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endirë Bushati	kryetare
Sami Nezaj	zëvendëskryetar
Suela Mustaj	anëtare
Gent Ibrahim	anëtar
Zylyftar Bregu	anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Mbi vlefshmërinë e licencës së subjektit televiziv privat vendor “TV Rex”.

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21, neni 33 pika 5 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VËREN SE:

Me vendimin nr. 859, datë 12.6.2009, KKRT-ja ka licencuar shoqërinë “Rex Mundi” sh.p.k., për subjektin televiziv privat vendor “TV Rex”, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat vendor në fushën e transmetimeve televizive analoge për të mbuluar me sinjal qarkun Korçë.

KKRT-ja konstaton se subjekti televiziv “TV Rex” nuk ka shlyer detyrimet financiare, pagesë vjetore për licencë dhe taksën për shërbimet rtv, pavarësisht njoftimeve të herëpashershme nga KKRT.

Kështu, KKRT me shkresat nr. 316 prot., datë 23.2.2010, nr. 1354 prot., datë 4.10.2010, nr. 581 prot., datë 4.4.2011, nr. 800 prot., datë 29.4.2011 dhe nr. 286 prot., datë 23.2.2012, por pavarësisht këtyre njoftimeve subjekti vazhdon të jetë debitor ndaj KKRT-së, në masën 257400 lekë, ndërsa ndaj Buxhetit të Shtetit në masën 576000 lekë. Vlera totale e detyrimit financiar është 833400 lekë.



Më tej, me shkresat nr. 774 prot., datë 5.6.2012 dhe nr. 1046 prot., datë 13.7.2012, i është ripërsëritur kërkesa për kryerjen e pagesave duke u paralajmëruar se në rast të mosshlyerjes së detyrimeve, nga ana e KKRT-së, do të ndiqen procedurat për bërjen të pavlefshme të licencës së subjektit.

Me vendimin nr. 20, datë 18.1.2013, KKRT-ja ka njoftuar subjektin televiziv privat vendor “TV Rex” për fillimin e procedurave për bërjen të pavlefshme të licencës së subjektit. Pavarësisht se është njoftuar edhe për vendimin e mësipërm, subjekti vazhdon të jetë debitor ndaj KKRT-së.

Neni 33 i ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikon se:

“Licenca bëhet e pavlefshme kur:

...

5. kërkuksi nuk realizon detyrimet financiare të parashikuara me ligj pas 90 ditëve nga momenti kur merr dijëni zyrtarisht për miratimin e saj.”.

PËR KËTO ARSYE:

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7 pika 21, nenit 33 pika 5 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të bëjë të pavlefshme licencën nr. 095/TVL të subjektit televiziv privat vendor “TV Rex”.
 2. Subjekti sipas pikës 1 të ndërpresë menjëherë transmetimin.
 3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditësh nga marrja dijëni, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endirë Bushati

VENDIM Nr. 108, datë 3.4.2013

MBI VLEFSHMËRINË E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR “D1”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endirë Bushati	kryetare
Sami Nezaj	zëvendëskryetar
Suela Musta	anëtare
Gent Ibrahimi	anëtar
Zylyftar Bregu	anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Mbi vlefshmërinë e licencës së subjektit televiziv privat vendor “TV D1”.

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21, neni 33 pika 5 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VËREN SE:

Me vendimin nr. 741, datë 7.11.2008, KKRT-ja ka licencuar shoqërinë “TV D1” sh.p.k., për subjektin televiziv privat vendor “TV D1”, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat vendor në fushën e transmetimeve televizive analoge për të mbuluar me sinjal rrethin e Peshkopisë.

KKRT-ja konstaton se subjekti televiziv “TV D1” nuk ka shlyer detyrimet financiare, pagesën vjetore për licencë dhe taksën për shërbimet rtv, pavarësisht njoftimeve të herëpashershme nga KKRT.

Kështu, KKRT-ja, me shkresat nr. 548 prot., datë 30.4.2010, nr. 582 prot., datë 4.4.2011, nr. 800 prot., datë 29.4.2011 dhe nr. 286 prot., datë 23.2.2012, ka njoftuar zyrtarisht subjektin televiziv “TV D1”, por pavarësisht këtyre njoftimeve subjekti vazhdon të jetë debitor ndaj KKRT-së, në masën 137400 lekë, ndërsa ndaj Buxhetit të Shtetit në masën 108000 lekë. Vlera totale e detyrimit financiar është 245400 lekë.

Më tej, me shkresat nr. 776 prot., datë 5.6.2012 dhe nr. 1063 prot., datë 13.7.2012, i është ripërsëritur kërkesa për kryerjen e pagesave duke u paralajmëruar se në rast të mosshlyerjes së detyrimeve, nga ana e KKRT-së, do të ndiqen procedurat për bërjen të pavlefshme të licencës së subjektit.

Me vendimin nr. 21, datë 18.1.2013, KKRT-ja ka njoftuar subjektin televiziv privat vendor “TV D1” për fillimin e procedurave për bërjen të pavlefshme të licencës së subjektit. Pavarësisht se është njoftuar edhe për vendimin e mësipërm, subjekti vazhdon të jetë debitor ndaj KKRT-së.

Neni 33 i ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikon se:

“Licenca bëhet e pavlefshme kur:

...

5. kërkuksi nuk realizon detyrimet financiare të parashikuara me ligj pas 90 ditëve nga momenti kur merr dijëni zyrtarisht për miratimin e saj”.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7 pika 21, nenit 33 pika 5 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të bëjë të pavlefshme licencën nr. 088/TVL të subjektit televiziv privat vendor “TV D1”.
2. Subjekti sipas pikës 1 të ndërpresë menjëherë transmetimin.
3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për zbatimin e këtij vendimi.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditësh nga marrja dijëni, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endirë Bushati

2753



VENDIM
Nr. 109, datë 3.4.2013

MBI VLEFSHMËRINË E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV KABLLOR
“TV FLAVIO CABLE”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endirë Bushati	kryetare
Sami Nezaj	zëvendëskryetar
Suela Musta	anëtare
Gent Ibrahim	anëtar
Zylyftar Bregu	anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Mbi vlefshmërinë e licencës së subjektit televiziv privat kabllor “TV Flavio Cable”.

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21, neni 33 pika 5 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VËREN SE:

KKRT-ja, me vendimin nr. 821, datë 24.4.2009, ka vendosur të licencojë subjektin, person fizik Xhevrie Koçi, për subjektin televiziv privat kabllor “TV Flavio Cable”, për të mbuluar me sinjal televiziv rrethin e Peshkopisë. Afati i licencës së subjektit përfundon në datën 4.6.2015.

KKRT-ja konstaton se subjekti televiziv kabllor “TV Flavio Cable” nuk ka shlyer detyrimet financiare, pagesë vjetore për licencë, pavarësisht njoftimeve të herëpashershme nga KKRT-ja.

Kështu, KKRT-ja me shkresat nr. 630 prot., datë 9.6.2009, nr. 269 prot., datë 15.2.2010, nr. 728 prot., datë 22.6.2010, nr. 64 prot., datë 14.1.2011, nr. 652 prot., datë 5.4.2011, nr. 700 prot., datë 14.4.2011 dhe nr. 192 prot., datë 2.2.2012, ka njoftuar zyrtarisht subjektin televiziv kabllor “TV Flavio Cable”, por pavarësisht këtyre njoftimeve, subjekti vazhdon të jetë debitor ndaj KKRT-së në masën 691.670 lekë.

Më tej, me shkresat nr. 758 prot., datë 5.6.2012 dhe nr. 1055 prot., datë 13.7.2012, i është ripërsëritur kërkesa për kryerjen e pagesave duke u paralajmëruar se në rast të mosshlyerjes së detyrimeve, nga ana e KKRT-së do të ndiqen procedurat për bërjen të pavlefshme të licencës së subjektit.

Me vendimin nr. 23, datë 18.1.2013, KKRT-ja ka njoftuar subjektin televiziv privat kabllor “TV Flavio Cable” për fillimin e procedurave për bërjen të pavlefshme të licencës së subjektit. Pavarësisht se është njoftuar edhe për vendimin e mësipërm, subjekti vazhdon të jetë debitor ndaj KKRT-së.

Neni 33 i ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikon se:

“Licenca bëhet e pavlefshme kur:

...

5. kërkuksi nuk realizon detyrimet financiare të parashikuara me ligj pas 90 ditëve nga momenti kur merr dijëni zyrtarisht për miratimin e saj”.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7 pika 21, nenit 33 pika 5 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të bëjë të pavlefshme licencën nr. 060/RTV kabllor të subjektit televiziv privat kabllor “TV Flavio Cable”.
 2. Subjekti sipas pikës 1 të ndërpresë menjëherë transmetimin.
 3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditësh nga marrja dijani, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endirë Bushati

VENDIM
Nr. 110, datë 3.4.2013

MBI VLEFSHMËRINË E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV KABLLOR
“TV ME KABËLL KAMZA”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endirë Bushati	kryetare
Sami Nezaj	zëvendëskryetar
Suela Musta	anëtare
Gent Ibrahim	anëtar
Zylyftar Bregu	anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Mbi vlefshmërinë e licencës së subjektit televiziv privat kabllor “TV me kabëll Kamza”.

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21, neni 33 pika 5 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VËREN SE:

KKRT-ja, me vendimin nr. 640, datë 12.11.2007, ka vendosur të licencojë subjektin, person fizik Ledio Shameti, për subjektin televiziv privat kabllor “TV me kabllor Kamza”, për të mbuluar me sinjal televiziv bashkinë Kamëz. Afati i licencës së subjektit përfundon në datën 10.12.2013.

KKRT-ja konstaton se subjekti televiziv kabllor “TV me kabllor Kamza” nuk ka shlyer detyrimet financiare, pagesë vjetore për licencë, pavarësisht njoftimeve të herëpashershme nga KKRT-ja.

Kështu, KKRT-ja me shkresat nr. 630 prot., datë 9.6.2009, nr. 269 prot., datë 15.2.2010, nr. 728 prot., datë 22.6.2010, nr. 653 prot., datë 5.4.2011, nr. 668 prot., datë 7.4.2011 dhe nr. 196/38 prot., datë 2.2.2012, ka njoftuar zyrtarisht subjektin televiziv kabllor “TV me kabllor Kamza”, por pavarësisht këtyre njoftimeve, subjekti vazhdon të jetë debitor ndaj KKRT-së në masën 1.920.830 lekë.

Më tej, me shkresat nr. 759 prot., datë 5.6.2012 dhe nr. 1053 prot., datë 13.7.2012, i është ripërsëritur kërkesa për kryerjen e pagesave, duke u paralajmëruar se në rast të mosshlyerjes së detyrimeve, nga ana e KKRT-së, do të ndiqen procedurat për bërjen të pavlefshme të licencës së subjektit.



Me vendimin nr. 24, datë 18.1.2013, KKRT-ja ka njoftuar subjektin televiziv privat kabllor “TV me kablo Kamza” për fillimin e procedurave për bërjen të pavlefshme të licencës së subjektit. Pavarësisht se është njoftuar edhe për vendimin e mësipërm, subjekti vazhdon të jetë debitor ndaj KKRT-së.

Neni 33 i ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikon se: “Licenca bëhet e pavlefshme kur:

...

5. kërkuar nuk realizon detyrimet financiare të parashikuara me ligj pas 90 ditëve nga momenti kur merr dijëni zyrtarisht për miratimin e saj”.

PËR KËTO ARSYE:

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7 pika 21, nenit 33 pika 5 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të bëjë të pavlefshme licencën nr. 050/RTV kabllor të subjektit televiziv privat kabllor “TV me kablo Kamza”.
 2. Subjekti sipas pikës 1 të ndërpresë menjëherë transmetimin.
 3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditësh nga marrja dijëni, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYETARE
Endirë Bushati

VENDIM Nr. 111, datë 3.4.2013

MBI VLEFSHMËRINË E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR “TV ABC”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endirë Bushati	kryetare
Sami Nezaj	zëvendëskryetar
Suela Musta	anëtare
Gent Ibrahim	anëtar
Zylyftar Bregu	anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Mbi vlefshmërinë e licencës së subjektit televiziv privat vendor “TV ABC”.

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21, neni 33 pika 5 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VËREN SE:

Me vendimin nr. 729, datë 29.9.2008, KKRT-ja ka vendosur të rinovojë licencën e subjektit televiziv privat vendor “TV ABC”. Ky subjekt është autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat vendor në fushën e transmetimeve televizive analoge për të mbuluar me sinjal rrethin Pogradec.

KKRT-ja konstaton se subjekti televiziv “TV ABC” nuk ka shlyer detyrimet financiare, pagesë vjetore për licencë dhe taksën për shërbimet rtv, pavarësisht njoftimeve të herëpashershme nga KKRT-ja.

Kështu, KKRT-ja me shkresat nr. 231 prot., datë 9.3.2009, nr. 546 prot., datë 14.5.2009, nr. 187 prot., datë 3.2.2010, nr. 583 prot., datë 4.4.2011, nr. 800 prot., datë 29.4.2011 dhe nr. 286 prot., datë 23.2.2012, por pavarësisht këtyre njoftimeve, subjekti vazhdon të jetë debitor ndaj KKRT-së, në masën 177.000 lekë, ndërsa ndaj Buxhetit të Shtetit në masën 312.000 lekë. Vlera totale e detyrimit financiar është 489.000 lekë.

Më tej, me shkresat nr. 775 prot., datë 5.6.2012 dhe nr. 1064 prot., datë 13.7.2012, i është ripërsëritur kërkesa për kryerjen e pagesave, duke u paralajmëruar se në rast të mosshlyerjes së detyrimeve, nga ana e KKRT-së, do të ndiqen procedurat për bërjen të pavlefshme të licencës së subjektit.

Neni 33 i ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikon se:

Licenca bëhet e pavlefshme kur:

...

5. kërkuar nuk realizon detyrimet financiare të parashikuara me ligj pas 90 ditëve nga momenti kur merr dijëni zyrtarisht për miratimin e saj”.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7 pika 21, nenit 33 pika 5 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të bëjë të pavlefshme licencën e subjektit televiziv privat vendor “TV ABC”.
 2. Subjekti sipas pikës 1 të ndërpresë menjëherë transmetimin.
 3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditësh nga marrja dijëni, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endirë Bushati



VENDIM
Nr. 112, datë 3.4.2013

MBI VLEFSHMËRINË E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR
“MAGIC STAR”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endirë Bushati	kryetare
Sami Nezaq	zëvendëskryetar
Suela Musta	anëtare
Gent Ibrahim	anëtar
Zylyftar Bregu	anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Mbi vlefshmërinë e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Magic Star”.

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21, neni 33 pika 1 dhe 5 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VËREN SE:

Me vendimin nr. 22/20, datë 23.10.2000, KKRT-ja ka licencuar subjektin person fizik Spiro Zguri, si operator radiofonik privat vendor në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore për radion private vendore “Magic Star”. Me vendimet nr. 559, datë 29.1.2007 dhe nr. 102, datë 28.3.2011 është vendosur rinovimi i licencës së subjektit. Licenca e subjektit ka përfunduar në datën 9.11.2012.

Në përfundim të afatit të licencimit, me shkresën nr. 1280 prot., datë 17.9.2012, KKRT-ja ka njoftuar subjektin për përfundimin e afatit, duke i kërkuar depozitimin e dokumentacionit për rinovim.

KKRT-ja konstaton se subjekti, përveç mungesës së interesit për rilicencim, ka detyrime të pashlyera ndaj KKRT-së dhe Buxhetit të Shtetit. Në total, ky detyrim është 137.100 lekë nga të cilat pagesë për licencë 79.500 lekë dhe taksë për shërbimet rtv 57.600 lekë.

Me vendimin nr. 30, datë 1.2.2013, KKRT-ja, ka njoftuar subjektin radiofonik privat vendor “Magic Star” për fillimin e procedurave për bërjen të pavlefshme të licencës për shkak të mungesës së interesit dhe mosshlyerjes së detyrimeve financiare, pagesës vjetore për licencë dhe taksës për shërbimet rtv, për vitet 2011 dhe 2012, duke i dhënë mundësinë që brenda 30 ditësh nga momenti i marrjes në dijeni për këtë vendim të parashtronte pretendimet e tij. Rezulton se subjekti nuk ka kthyer përgjigje për vendimin e mësipërm, por as nuk ka shlyer detyrimet financiare ndaj KKRT-së.

Neni 33 i ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikon se:

“Licenca bëhet e pavlefshme kur:

1. mbaron afati i vlefshmërisë dhe ajo nuk është rinovuar;

...

5. kërkuesi nuk realizon detyrimet financiare të parashikuara me ligj pas 90 ditëve nga momenti kur merr dijeni zyrtarisht për miratimin e saj”.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7 pika 21, nenit 33 pika 1 dhe 5 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të bëjë të pavlefshme licencën nr. 003/FML të subjektit radiofonik privat vendor “Magic Star”.
 2. Subjekti sipas pikës 1 të ndërpresë menjëherë transmetimin.
 3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditësh nga marrja dijani, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE
Endirë Bushati**

**VENDIM
Nr. 113, datë 3.4.2013**

**MBI VLEFSHMËRINË E LICENCËS SË DISA SUBJEKTEVE TELEVIZIVE PRIVATE
KABLLORE**

Në mbështetje të nenit 7 pika 21, nenit 34 pika 2 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të heqë licencën e subjekteve televizive private kabllore të listës së mëposhtme për shkak të mosshlyerjes së detyrimeve financiare, pagesës vjetore për licencë për vitet 2011 dhe 2012, si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i subjektit	Rrethet	Detyrimet në vite		
			2011	2012	Gjithsej
1	TV me kabllo Elbasan	Elbasan	1175	1000	2175
2	TV me kabllo Portëz	Fier	200	200	400
3	TV me kabllo Multivizion	Kavajë	433	400	833
4	TV me kabllo Kruja	Krujë	267	200	467
5	TV me kabllo Voskop	Korçë	200	200	400
6	Tv Me kabllo I-Miri Cable	Korçë	1050	1000	2050

2. Subjektet sipas pikës 1 të ndërpresin menjëherë transmetimin.
 3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditësh nga marrja dijani, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE
Endirë Bushati**



VENDIM
Nr. 114, datë 3.4.2013

MBI MOSRINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR
“TV KRISTAL”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endirë Bushati	kryetare
Sami Nezaq	zëvendëskryetar
Suela Musta	anëtare
Gent Ibrahim	anëtar
Zylyftar Bregu	anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Mbi mosrinnovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor “TV Kristal”.

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21, neni 33 pika 1 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

VËREN SE:

Personi fizik Thanas Kote, është licencuar nga KKRT-ja, me vendimin nr. 57, datë 17.8.2001, si operator televiziv privat vendor në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për televizionin privat vendor “TV Kristal”. Me vendimin nr. 510, datë 29.9.2006, KKRT-ja ka rinovuar licencën për këtë subjekt. Licenca e subjektit ka përfunduar në datën 29.8.2011.

Në përputhje me ligjin nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullores “Mbi licencimin dhe rilicencimin e operatorëve radio e televizive”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010 të KKRT-së dhe urdhrin nr. 43, datë 20.2.2013, i ndryshuar, të Kryetarit të KKRT-së, në datën 23.2.2013, Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit u mblodh për të shqyrtuar ndër të tjera, edhe aplikimin për rinovimin e licencës për subjektin televiziv privat vendor “TV Kristal”.

Bazuar në pikën 21 të “Dispozitave të përbashkëta”, të rregullores “Mbi licencimin dhe rilicencimin e operatorëve radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010 të KKRT-së subjektit televiziv privat vendor “TV Kristal”, i është dërguar shkresa nr. 343 prot., datë 1.3.2012 për plotësimin e mangësive në dokumentacionin për rinovimin e licencës. Konkretisht mangësitë konsistojnë në:

- ekstrakti i QKR-së ishte tej afatit 1-mujor të përcaktuar në pikën 13 të rregullores “Mbi licencimin dhe rilicencimin e operatorëve radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 29.1.2010 të KKRT-së, sipas së cilës: “Dokumentacioni që përmban zarfi dhe që merret në institucionet shtetërore, duhet të jetë marrë jo më vonë se një muaj”, si dhe nuk ishte paraqitur deklarata për vërtetësinë e të dhënave të paraqitura;

- nuk ishin depozituar bilancet kontabël për 5 vitet e licencimit;

- nuk ishte paraqitur i plotë Bordi Drejtues dhe CV-të e firmosura, deklaratat e tyre që janë dakord të jenë në Bord Drejtues; nuk ishin depozituar kontratat e punës, si dhe pagesa e sigurimeve shoqërore për gjithë periudhën e mëparshme të licencimit;

- nuk ishte paraqitur planimetria e pikës transmetuese dhe e godinës qendrore; nuk ishte paraqitur bllokskema e funksionimit të studios së montazhit dhe të funksionimit të lidhjeve pikë më pikë, si dhe nuk identifikohet autori i projektit teknik.

Subjekti televiziv privat vendor “TV Kristal” nuk ka kthyer përgjigje ndaj shkresës së sipërcituar, duke mos realizuar plotësimin e mangësive të konstatuara në dokumentacionin për rinovimin e licencës.

Neni 33 pika 1 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikon se:

“Licenca bëhet e pavlefshme kur:

1. mbaron afati i vlefshmërisë dhe ajo nuk është rinovuar;”.

Në mbështetje të dispozitës së sipërcituar, rezulton se subjektit televiziv privat vendor “TV Kristal” i ka përfunduar afati i vlefshmërisë së licencës dhe ky subjekt nuk është rilicencuar, me gjithë mundësinë e dhënë për plotësimin e mangësive në aplikimin për rinovimin e licencës.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7 pika 21, nenit 33 pika 1 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të mosrinovojë licencën për subjektin televiziv privat vendor “TV Kristal”.
 2. Të bëjë të pavlefshme licencën nr. 052/TVL të subjektit televiziv privat vendor “TV Kristal”.
 3. Subjekti sipas pikës 1 të ndërpresë menjëherë transmetimin.
 4. Ngarkohet administrata e KKRT-së për zbatimin e këtij vendimi.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditësh nga marrja dijoni, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endirë Bushati

VENDIM

Nr. 115, datë 3.4.2013

MBI VLEFSHMËRINË E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR “TV ARV”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endirë Bushati	kryetare
Sami Nezaj	zëvendëskryetar
Suela Mustaj	anëtare
Gent Ibrahim	anëtar
Zylyftar Bregu	anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Mbi vlefshmërinë e licencës së subjektit televiziv privat vendor “TV ARV”.

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21, neni 33 pika 5 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VËREN SE:

Me vendimin nr. 22/8, datë 23.10.2000, KKRT-ja ka licencuar shoqërinë “George” sh.p.k., për subjektin televiziv privat vendor “TV ARV”, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat vendor në fushën e transmetimeve televizive analoge për të mbuluar me sinjal rrethin Pogradec.



KKRT-ja konstaton se subjekti televiziv “TV ARV” nuk ka shlyer detyrimet financiare, pagesë vjetore për licencë dhe taksën për shërbimet rtv, pavarësisht njoftimeve të herëpashershme nga KKRT-ja.

Kështu, KKRT-ja me shkresat nr. 800 prot., datë 29.4.2011 dhe nr. 286 prot., datë 23.2.2012, por pavarësisht këtyre njoftimeve, subjekti vazhdon të jetë debitor ndaj KKRT-së, në masën 216.000 lekë, ndërsa ndaj Buxhetit të Shtetit në masën 111.600 lekë. Vlera totale e detyrimit financiar është 327.600 lekë.

Me vendimin nr. 29, datë 1.2.2013, KKRT-ja ka vendosur të njoftojë subjektin televiziv privat vendor “TV ARV” për fillimin e procedurave për heqjen e licencës për shkak të mosshlyerjes së detyrimeve financiare, pagesës vjetore për licencë dhe taksës për shërbimet rtv, për vitet 2011 dhe 2012, duke i dhënë mundësinë që brenda 30 ditësh nga momenti i marrjes në dijeni për këtë vendim të parashtronte pretendimet e tij. Rezulton se subjekti nuk ka kthyer përgjigje për vendimin e mësipërm, por as nuk ka shlyer detyrimet financiare ndaj KKRT-së.

Neni 33 i ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikon se:

“Licenca bëhet e pavlefshme kur:

...

5. kërkuesi nuk realizon detyrimet financiare të parashikuara me ligj pas 90 ditëve nga momenti kur merr dijeni zyrtarisht për miratimin e saj”.

PËR KËTO ARSYE:

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7 pika 21, nenit 33 pika 5 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të bëjë të pavlefshme licencën nr. 008/FML të subjektit televiziv privat vendor “TV ARV”.
 2. Subjekti sipas pikës 1 të ndërpresë menjëherë transmetimin.
 3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditësh nga marrja dijeni, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endirë Bushati

KËRKESË

Shtetasi Adem Tata, i biri i Shefitit dhe i Bajames, i datëlindjes 4.4.1942, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, shpalljen të zhdukur të djalit të tij Haxhi Tata, lindur dhe banues në fshatin Garunjas, Lushnjë dhe caktimin e tij si administrator të pasurisë.

KËRKUESI
Adem Tata

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 25.4.2013
Doli nga shtypi më 25.4.2013

	Formati: 61x86/8
--	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 36 lekë